

Sfidat në ndjekjen dhe gjykimin e krimeve të rënda



Autore: Medina Kadriu dhe Valentina Shahini-Grajqevci

Redaktor: Gzim Shala

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD dhe ajo nuk pasqyron pikëpamjet e Byrosë për Çështje të Narkotikëve Ndërkombëtar dhe Zbatimit të Ligjit (INL) - Departamenti i Shtetit Amerikan dhe NED-it.

RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD

Rr. Ilaz Agushi
Prishtinë
E: info@kli-ks.org
www.kli-ks.org

Përkrahur nga:

Korrik, 2022
Prishtinë, Republika e Kosovës



**National Endowment
for Democracy**
Supporting freedom around the world

Përmbajtja

1. Përmbledhja ekzekutive	4
2. Shkeljet esenciale të gjykatave të shkallës së parë	5
3. Shkaktarët tjerë të zvarritjeve të procedurave penale	6
4. Trajtimi i lëndëve nga Gjykatat Themelore	8
5. Trajtimi i lëndëve nga Prokuroritë Themelore	10
6. Mosvendosja në kërkesën pasurore juridike	11
7. Mosaplikimi i dënimeve plotësuese.....	13
8. Konfiskimi i zgjeruar	13

1. Përmbledhja ekzekutive

Departamentet për Krime të Rënda (DKR) të Gjykatave Themelore (GjTh) të Republikës së Kosovës, vijnë të ballafaqohen me lëndë që barten vit pas viti, duke rezultuar kështu në numër shumë të madh të lëndëve që mbeten të pazgjidhura çdo vit. Ende nuk ka arritur të krijohet një sistem gjyqësor efikas, ku lëndët procedohen brenda afateve ligjore.

Gjatë vitit 2021, DKR-të e shtatë GjTh kanë arritur të zgjidhin më pak lëndë sesa që kanë pranuar. Kështu, përgjatë këtij viti, nuk ka pasur progres në uljen e numrit të lëndëve të pazgjidhura. Mes gjykatave ka diferencë të konsiderueshme sa i përket mesatares së përgjithshme të zgjidhjes së lëndëve. Nuk ka të dhëna nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) apo gjykatat se përse ndodhë një gjë e tillë. Prandaj, rekomandohet që kjo çështje të trajtohet nga KGJK, për të përcaktuar shkaqet që kanë sjellë këtë diferencë. Ky vit paraqet kthim mbrapa në efikasitetin e DKR të GjTh, për shkak se numri i lëndëve të pazgjidhura në fund të vitit 2021 ka qenë më i lartë se në fund të vitit 2020.

Ndërkaq, edhe DKR-të e Prokurorive Themelore (PTh) nuk kanë arritur që të zgjidhin lëndë më shumë se sa që kanë pranuar dhe, si rrjedhojë, në fund të vitit 2021 (në raport me fundin e vitit 2020) është ngritur numri i lëndëve të pazgjidhura. Nëse krahasohet numri i lëndëve të zgjidhura në raport me numrin e prokurorëve, shihet se ka një çekuilibër edhe në mesataren e zgjidhjes së lëndëve në secilën prokurori.

Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) ka gjetur se një numër i konsiderueshëm i rasteve kthehen në rigjykim për shkak të shkeljeve esenciale nga gjykatat e shkallës së parë. Në këtë rast, shqetësuese është natyra e këtyre shkeljeve, ku një numër i konsiderueshëm i tyre kanë të bëjnë me shkelje të parimeve bazë të drejtësisë penale. Këto shkelje më pastaj bëhen shkaktarë të zvarritjeve të lëndëve, e jo në pak raste lëndët arrijnë edhe parashkrimin.

Ndër faktorët tjerë që IKD ka identifikuar, të cilët ndikojnë në zvarritjen e procedurës penale, janë edhe vonesat në caktimin e seancave dhe ndërrimi i anëtarëve të trupit gjykues apo kryetarit të trupit gjykues, ku në dy rrethanat e fundit dhe në rastin kur kanë kaluar 3 muaj nga mbajtja e seancës së fundit gjykimi duhet të fillojë rishtas.

Përveç rasteve, në të cilat procedohet me pranim të fajësisë apo marrëveshje për pranim të fajësisë, nga rastet e analizuara vërehet se të pandehurit në një proces gjyqësor në DKR mesatarisht qëndrojnë mbi 3 vite. IKD ka identifikuar një rast ku deri më 31 dhjetor të vitit 2021 kanë kaluar gati 12 vite në proces gjyqësor dhe gjatë gjithë kësaj kohe i pandehuri ka qëndruar në paraburgim.

Në analizimin e 108 aktgjykimeve, IKD ka gjetur se në 98 raste DKR-të nuk kanë vendosur sa i përket kërkesës pasurore-juridike por palët e dëmtuara janë udhëzuar në kontest civil. IKD ka gjetur se kësaj situatë i kontribuon edhe fakti që përfaqësuesit e palëve të dëmtuara nuk parashtrojnë para gjykatës dëmin e shkaktuar nga kryesi i veprës penale e as nuk ofrojnë prova lidhur me këtë, çka i pamundëson gjykatës vendosjen mbi kërkesën pasurore-juridike.

IKD po ashtu ka hasur në raste të shumta kur ka qenë i mundur aplikimi i dënimeve plotësuese, por nuk janë shqiptuar nga ana e gjykatës. Vërehet sidomos mungesa e dënimit plotësues të ndalimit të ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik.

Një ndër mjetet kryesore për luftimin e kriminalitetit, krahas shqiptimit të dënimeve kryesore, alternative dhe plotësuese, është edhe konfiskimi i pasurisë së përfituar përmes veprës penale. Gjatë vitit 2021, në asnjë rast nuk është aplikuar Ligji për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë (LKZKP) nga Prokurorët e Shtetit.

2. Shkeljet esenciale të gjykatave të shkallës së parë

Sikurse në vitet paraprake¹, edhe në vitin 2021, për shumë raste që kanë marrë epilog në shkallë të parë, është konstatuar nga instancat më të larta se gjatë trajtimit të tyre ka pasur shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale. IKD gjen se shkelja esenciale e dispozitave të procedurës penale është një ndër arsyet e shpeshta të kthimit të rasteve në rigjykim. Në këto raste gjykata e shkallës së dytë e ka të pamundur të veprojë ndryshe pos ta kthejë lëndën në rigjykim, dhe, si rrjedhojë, shkaktohen vonesa të konsiderueshme në procedimin e lëndëve.

Gjatë analizimit të aktgjykimeve të Gjykatës së Apelit, IKD e ka parë problematike natyrën e këtyre shkeljeve esenciale. Përkatësisht, në këto aktgjykime, bëhet fjalë për shkelje të parimeve bazë të drejtësisë penale, që në fakt, nuk do të duhej të ndodhnin dhe të bëheshin shkak për kthimin e rasteve në pikën zero. Disa nga këto raste problematike janë përshkruar në vijim.

Në një rast tjetër, gjykata e shkallës së parë fillimisht kishte mbajtur seancë dëgjimore mbi marrëveshjen për pranimin e fajësisë. Në seancë dëgjimore fajësia ishte pranuar, por më pas ishte apeluar nga palët në Apel, ku rasti ishte kthyer në rigjykim. Me kthimin e rastit në rigjykim, pala mbrojtëse ishte tërhequr nga kjo marrëveshje, ndërkaq gjykata e shkallës së parë kishte proceduar direkt me shqyrtim kryesor, duke mos përfillur dispozitat e Kodit të Procedurës Penale të cilat parashohin mbajtjen e shqyrtimit fillestar e pastaj atij të dytë, ku aktakuza e prokurorisë i nënshtrohet kontrollit gjyqësor.² Në fund, Gjykata e Apelit gjeti shkelje esenciale të dispozitave në këtë proces gjyqësor dhe rasti u kthye në rigjykim.

E, në një rast të gjykatës së shkallës së parë, Apeli ka gjetur tri shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale. Shkelja e parë konsistonte në faktin se i akuzuari ishte i nacionalitetit serb, ndërkaq mbrojtjes së tij nuk i janë përkthyer provat e administruara në

¹ Thaqi M. Nocaj D. “Drejtësia e vonuar në Kosovë”, IKD (Dhejtor 2021), fq.5, në: <https://kli-ks.org/drejtësia-e-vonuar-ne-kosove> ; Bajraktari, L. “Drejtësia në shkallë të dytë”, IKD, (mars 2020), Fq.68, në: <https://kli-ks.org/drejtësia-ne-shkalle-te-dyte/> (Qasur së fundi 17 qershor 2022).

² Vendimi i Gjykatës së Apelit, numër PAKR.nr.76/2021, i datës 26 shkurt 2021.

shqyrtimin gjyqësor, duke pamundësuar kështu dhënien e mbrojtjes efektive. Tutje lidhur me këtë shkelje, Apeli kishte gjetur se përkundër faktit se kishte pasur përkthyes në shqyrtim gjyqësor, përmbajtja e provave nuk ishte përkthyer ashtu që ta kuptonte i akuzuari me saktësi përmbajtjen e secilës provë. Shkelja e dytë konsistonte në atë se, sa i përket operacionit të bastisjes, ai ishte kryer në mënyrë të pajustificueshme me urdhër të kryeprokurorit të Ferizajt ku tek më pas gjykata kishte bërë aprovimin (retroaktiv) të urdhrit. Apeli ka gjetur që nuk rezulton asnjë rrethanë në shkresat e lëndës të ketë pasur arsyeshmëri për hyrjen e tillë pa urdhër të gjykatës. E po ashtu është konstatuar se në rastin konkret urdhri i gjyqtarit të procedurës nuk rezulton të jetë lëshuar as si urdhëresë gojore, por se bastisja ishte urdhëruar nga prokurori siç rezulton nga konstatimet e policisë dhe raportet e policisë. Shkelja e tretë dhe e fundit konsiston në atë se vepra penale ishte e dënueshme deri në 10 vite burgim, ndërkaq për veprat e tilla penale (të dënueshme me mbi tri vite burgim) duhet të fillohet hetimi për t'u ngritur aktakuza. Përkundër kësaj, në këtë rast është ngritur aktakuzë drejtpërdrejt dhe pa filluar hetimi janë ndërmarr veprime hetimore, siç janë marrja në pyetje e të dyshuarit, ekspertizat e armëve të zjarrit, etj.³

Në anën tjetër, në një rast tjetër ku ishin shkelur parimet e drejtësisë, por se rasti nuk kishte pasur arsye të kthehet në rigjykim ishte rasti kur Gjykata e Apelit ka gjetur se shkalla e parë ka shkelur një nga parimet bazë të drejtësisë penale, “ne bis in idem”, të paraparë në nenin 4 të KPPRK. Ndaj të akuzuarit ishin ngritur dy aktakuza për të njëjtën çështje, ku gjykata kishte proceduar me të dyja lëndët ndaras dhe kishte marrë aktgjykime dënuese për të njëjtën çështje. Njëri aktgjykim ishte bërë i plotfuqishëm, kurse tjetri ishte apeluar, ku ishte konstatuar shkelja e cekur më lartë⁴.

Kështu, krahas shkeljeve të tjera esenciale, në rastet e evidentuara më lart shihet se kemi të bëjmë me shkelje të parimeve bazë të drejtësisë penale. Këto shkelje përbëjnë arsye për kthim të rasteve në rigjykim, pasi rrethana të kësaj natyre janë të patejkalueshme për Gjykatën e Apelit.

3. Shkaktarët tjerë të zvarritjeve të procedurave penale

IKD ka gjetur se në mbi 90% të rasteve, gjykatësit shkelin afatet ligjore për trajtimin e rasteve sipas Kodit nr. 04/L-123 të Procedurës Penale.⁵ Ndër faktorët kryesorë që IKD ka identifikuar krahas kthimit të rasteve në rigjykim të trajtuar më lart, të cilët ndikojnë në zvarritjen e procedurës penale, janë edhe vonesat në caktimin e seancave dhe ndërrimi i anëtarëve të trupit gjykues apo kryetarit të trupit gjykues, ku në rastin e ndërrimit të anëtarëve apo kryetarit apo në rastin kur kanë kaluar 3 muaj nga mbajtja e seancës së fundit gjykimi duhet të fillojë rishtas.⁶

³ Vendimi i Gjykatës së Apelit, numër PAKR.nr.436/2020, i datës 22 janar 2021.

⁴ Vendimi i Gjykatës së Apelit, numër PAKR.nr.361/2021, i datës 12 tetor 2021.

⁵ Neni 5, paragrafi 2, neni 242, paragrafi 4, neni 285, paragrafi 2, neni 314, paragrafi 1 i Kodit nr. 04/L-123 të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

⁶ “Gjykimi fillon rishtazi, polici s’e pranon se mori ryshfet, dëshmitarja thotë se ai kishte marrë 20 euro”, *Betimi për Drejtësi* (11 nëntor 2021), në: <https://betimiperdrejtesi.com/gjykimi-fillon-rishtazi-polici-se-pranon->

Zvarritja e rasteve gjyqësore për shkak të kthimit të shpeshtë të rasteve në rigjykim konsiderohet shkelje e të drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor, sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Për shembull, në rastin *Kaçiu dhe Kotorri k. Shqipërisë*. GjEDNJ kishte konstatuar se një praktikë e tillë e tejzgjatjes së procedurave gjyqësore është e dëmshme për të drejtat e të pandehurve. Sipas këtij aktgjykimi: “Problemi kryesor në çështjen në fjalë, të cilin Gjykata e ka shqyrtuar edhe në një çështje të mëparshme kundër shtetit të paditur, është kthimi i shpeshtë i çështjeve për rigjykim nga gjykatat më të larta te gjykatat më të ulëta. Gjykata është e mendimit se kjo vonesë i atribuohet tërësisht gjykatave të vendit. Në këtë rast procesi penal zgjati 6 vjet dhe 11 muaj, zgjatje e cila çoi në një shkelje që i atribuohet gjykatave të brendshme.”⁷

Përveç rasteve, në të cilat procedohet me pranim të fajësisë apo me marrëveshje për pranim të fajësisë, nga rastet e analizuar, të pandehurit në një proces gjyqësor qëndrojnë mbi tri vite.

Rast ilustrues në këtë kuptim është rasti “Çekiçi”,⁸ në të cilin deri më 31 dhjetor të vitit 2021 kanë kaluar gati 12 vite në proces gjyqësor, ku gjatë gjithë kësaj kohe i pandehuri ka qëndruar në paraburgim⁹, ndërkaq rasti është kthyer dy herë në rigjykim. Pastaj, rasti i Enver Sekiraqës¹⁰ është kthyer në rigjykim dy herë dhe ende nuk ka një epilog, ku nga ngritja e aktakuzës deri në fund të vitit 2021 kanë kaluar mbi 7 vite e gjysmë.

Mungesat e paarsyetuara të prokurorëve dhe avokatëve bëhen shpeshherë shkak për shtyrjen e seancave gjyqësore, gjë e cila ndikon edhe në zvarritjen e procedurës. Për të adresuar një problem të tillë, gjykatësit duhet të ndërmarrin veprimet ligjore të përcaktuara në nenin 64 të KPPRK, duke njoftuar Kryeprokurorët respektivë apo duke shqiptuar gjoha avokatëve dhe duke njoftuar Odën e Avokatëve të Kosovës në rastet kur veprimet e palëve të caktuara kanë për qëllim zvarritjen e procedurës penale. Gjatë monitorimit, IKD ka hasur raste të shumta ku nuk janë aplikuar asnjë nga këto mundësi të cilat gjykata i ka në dispozicion për adresimin e këtij problemi.

Gjatë monitorimit sistematik të sistemit gjyqësor, janë evidentuar raste të shumta ku prokurorët nuk zbatojnë obligimin e tyre për sigurimin e mbrojtësit apo të akuzuarit me

[se-mori-ryshfet-deshmitarja-thote-se-ai-kishte-marre-20-euro/](https://betimiperdrejtesi.com/gjykimi-fillon-rishtazi-polici-se-pranon-se-mori-ryshfet-deshmitarja-thote-se-ai-kishte-marre-20-euro/); “Ndryshohet trupi gjykues, rifillon gjykimi ndaj dy ish-zyrtarëve të cilët akuzohen se regjistruan prona me aktgjykim të falsifikuar”, *Betimi për Drejtësi* (11 nëntor 2021), në: <https://betimiperdrejtesi.com/gjykimi-fillon-rishtazi-polici-se-pranon-se-mori-ryshfet-deshmitarja-thote-se-ai-kishte-marre-20-euro/>; “Fillon rishtazi gjykimi për vrasje në tentativë, babë e bir sërish deklarohen të pafajshëm”, *Betimi për Drejtësi* (3 qershor 2021), në: <https://betimiperdrejtesi.com/fillon-rishtazi-gjykimi-per-vrasje-ne-tentative-babe-e-bir-serish-deklarohen-te-pafajshem/> (Qasur së fundi 17 qershor 2022).

⁷ *Kaçiu and Kotorri v. Albania*, app no Nr.33192/07 dhe 33194/07, (ECtHR, December 9, 2013).

⁸ “Dëshmitari jashtë vendit, shtyhet gjykimi për vrasje i njohur si rasti “Çekiçi”, *Betimi për Drejtësi* (09 nëntor 2021), në: <https://betimiperdrejtesi.com/deshmitari-jashte-vendit-shtyhet-gjykimi-per-vrasje-i-njohur-si-rasti-cekici/> (Qasur së fundi 17 qershor 2022).

⁹ Neni 5, paragrafi 3 i Kodit nr. 04/L-123 të Procedurës Penale: “Çdo heqje lirie, e sidomos kohëzgjatja e paraburgimit në procedurë penale, duhet zvogëluar në kohën sa më të shkurtër të mundshme”; Neni 185, paragrafi 2 i Kodit nr. 04/L-123 të Procedurës Penale: “Paraburgimi duhet të reduktohet në kohën sa më të shkurtër të mundshme. Kur i pandehuri mbahet në paraburgim, të gjitha organet që marrin pjesë në procedurën penale dhe organet që ofrojnë ndihmën juridike detyrohen të veprojnë me nguti të posaçme”.


¹⁰ “Ish-gjyqtarja thotë se bastisja në lokalin Sekiraqa ishte bërë pa urdhër të saj dhe me nguti nga policia”, *Betimi për Drejtësi* (08 shtator 2021), në: <https://betimiperdrejtesi.com/ish-gjyqtarja-thote-se-bastisja-ne-lokalin-sekiraqa-ishte-bere-pa-urdher-te-saj-dhe-me-nguti-nga-policia/> (Qasur së fundi 17 qershor 2022).

materialët që janë pjesë e lëndës, ashtu siç parashihet me nenin 244 të KPPK, ku në shumë raste të akuzuarit me shkresa të lëndës pajisen vetëm gjatë shqyrtimit fillestar.¹¹ Kjo përpos që shkelë të drejtat e të pandehurit, ndikon edhe në zvarritjen e rasteve, për shkak se ndodhë që pikërisht për këtë shkak të dështojë seanca.¹²

Ndërrimi i kryetarit apo anëtarëve të tjerë të trupit gjykues është një arsye tjetër që shkakton zvarritje të rasteve¹³. Kjo pasi sipas Kodit të Procedurës Penale, në këto raste, gjykimi duhet të filloj nga pika rishtas.¹⁴ Për këtë arsye, IKD rekomandon që si Këshilli Gjyqësor i Kosovës ashtu edhe kryetarët e gjykatave të bëjnë administrim adekuat të drejtësisë, në mënyrë që mos të paraqiten situata të kësaj natyre. Në rastin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, kjo duhet të reflektohet veçanërisht përmes planifikimit adekuat të avancimit të gjyqtarëve.

4. Trajtimi i lëndëve nga Gjykatat Themelore

Gjatë vitit 2021, DKR-të e shtatë GjTh kanë pasur në punë gjithsej 6,128 lëndë, prej të cilave kanë trashëguar 3,892 lëndë, ndërsa kanë pranuar në punë 2,236 lëndë. Prej këtyre lëndëve në punë, këto DKR kanë zgjidhur 2,155, ndërkaq si të pazgjidhura kanë mbetur 2,873 lëndë. Pra, gjatë vitit 2021, DKR-të kanë arritur të zgjidhin më pak lëndë se sa që kanë pranuar. Kështu, përgjatë këtij viti, nuk ka progres në uljen e numrit të lëndëve të pazgjidhura.



Grafikoni 1: Numri i lëndëve të zgjidhura dhe pazgjidhura në DKR të GjTh-ve për vitin 2021

Gjatë vitit 2021, DKR e Gjykatës Themelore në Prishtinë ka qenë ndër gjykatat më të ngarkuara me lëndë (2,207 lëndë në punë), nga të cilat i kanë mbetur pa zgjidhur 1,543 lëndë në fund të vitit. Po ashtu, ngarkesë e madhe me lëndë evidentohet edhe në DKR të GjTh në Mitrovicë (1,648 lëndë në punë), nga të cilat i kanë mbetur të pazgjidhura 1,272 lëndë në

¹¹“Lavdim Krasniqi dhe të tjerët deklarohen të pafajshëm për korrupsion e vepra tjera”, *Betimi për Drejtësi* (06 tetor 2021), në: <https://betimiperdrejtesi.com/lavdim-krasniqi-dhe-te-tjeret-deklarohen-te-pafajshem-per-korrupsion-e-vepra-tjera/>; “Mbrojtja pa shkresa të lëndës, dështon gjykimi për korrupsion ndaj dy zyrtarëve të komunës së Fushë Kosovës”, *Betimi për Drejtësi* (05 nëntor 2021), në: <https://betimiperdrejtesi.com/mbrojtja-pa-shkresa-te-lendes-deshton-gjykimi-per-korrupsion-ndaj-dy-zyrtareve-te-komunes-se-fushe-kosoves/> (Qasur së fundi 17 qershor 2022).

¹² “I akuzuari nuk pajiset me shkresa të lëndës, sërish shtyhet gjykimi për keqpërdorim dhe mashtrim në prokurim publik”, *Betimi për Drejtësi* (15 korrik 2021), në: <https://betimiperdrejtesi.com/i-akuzuari-nuk-pajiset-me-shkresa-te-lendes-serish-shtyhet-gjykimi-per-keqperdorim-dhe-mashtrim-ne-prokurim-publik/>. (Qasur së fundi 17 qershor 2022).

¹³ Shih fusnotën nr.7.

¹⁴ Neni 311 i Kodit nr.04/L-123 i Procedurës Penale.

fund të 2021. DKR në GjTh në Gjakovë ka qenë më së paku e ngarkuar me lëndë (330 lëndë në punë), nga të cilat në fund të vitit 2021 i kanë mbetur të pazgjidhura 144 lëndë.

Gjykata Themelore	Lëndë të trashëguara	Lëndë të pranuar	Gjithsej në punë	Të zgjidhura	Të pazgjidhura
Prishtinë	1452	755	2207	664	1543
Gjilan	308	316	624	260	364
Prizren	175	176	351	193	158
Mitrovicë	1310	338	1648	376	1272
Gjakovë	140	190	330	186	144
Pejë	221	219	440	264	176
Ferizaj	286	242	528	212	316

Tabela 1: Ngarkesa me lëndë në Departamentet për Krime të Rënda në shtatë Gjykatat Themelore të Republikës së Kosovës.

Nëse e krahasojmë numrin e lëndëve të zgjidhura me numrin e gjyqtarëve të angazhuar në DKR, atëherë del se, si mesatare, efikasitetin më të lartë e ka pasur DKR në GjTh në Gjakovë, ku, mesatarisht, secili gjyqtar ka zgjidhur nga 7.75 lëndë në muaj, pasuar nga GjTh në Prishtinë (6.15), ajo në Mitrovicë (5.22), Ferizaj (4.42), Pejë (4.40) dhe Prizren (4.02). Ndërsa, mesatarja më e ulët në këtë rast evidentohet tek DKR në Gjilan (3.61). Në këtë mënyrë, shohim se mes gjykatave ka diferencë të konsiderueshme sa i përket mesatares së përgjithshme të zgjidhjes së lëndëve. Nuk ka të dhënë nga KGJK apo gjykatat se përse ndodhë një gjë e tillë. Për këtë arsye, rekomandohet që kjo çështje të trajtohet nga KGJK, për të përcaktuar shkaqet që sjellin këtë diferencë.

Përkundër faktit se qëllim i përgjithshëm i gjyqësorit është ulja e numrit të lëndëve të pazgjidhura të cilat barten vit pas viti, gjatë vitit 2021, numri i lëndëve të pazgjidhura është rritur për 81 lëndë. DKR i GjTh në Prishtinë, në fund të vitit 2021, ka pasur në punë 91 lëndë më shumë sesa në vitin 2020. Rritje ka pasur edhe në DKR të GjTh në Gjilan, Ferizaj dhe Gjakovë. Diferenca më pozitive në këtë rast evidentohet në rastin e DKR të GjTh në Pejë.

DKR i GjTh	Diferenca mes numrit të lëndëve të pranuar dhe të zgjidhura
Prishtinë	+91
Pejë	-45
Prizren	-17
Ferizaj	+30
Mitrovicë	-38
Gjilan	+56
Gjakovë	+4
Total	+81


Tabela 2: Diferenca në mes të numrit të lëndëve të pranuar dhe të zgjidhura gjatë vitit 2021 në DKR të GjTh-ve.

Nisur nga fakti se arsyeja kryesore e zvarritjes së rasteve gjyqësore konsiderohet numri i madh i lëndëve të pazgjidhura, këto të dhëna paraqesin mungesë të avancimit në këtë fushë.

Për më tepër, numri i lëndëve të pazgjidhura në fund të vitit 2021, ka qenë më i lartë se në fund të vitit 2020. Për këtë arsye, KGJK dhe gjykatat duhet të analizojnë gjendjen me lëndë në këto departamente dhe të ndërmarrin veprime konkrete që këto departamente të hyjnë në binar të uljes së ngarkesës me lëndë. Kjo mund të bëhet vetëm nëse DKR-të vazhdimisht zgjidhin lëndë më shumë sesa që pranojnë.

5. Trajtimi i lëndëve nga Prokuroritë Themelore

DKR-të në shtatë Prokuroritë Themelore të Republikës së Kosovë, kanë pasur në punë gjithsej 14,425 lëndë, prej të cilave kanë trashëguar 8,386 lëndë nga viti paraprak, ndërsa kanë pranuar në punë 6,039 lëndë të reja. Prej këtyre lëndëve në punë, DKR-të e PTh kanë zgjidhur 5,771 apo 40% lëndëve, ndërkaq si të pazgjidhura i kanë mbetur 8,654 lëndë apo 60% të lëndëve, të cilat janë bartur në vitin 2022.¹⁵ Kështu, këto DKR nuk kanë arritur që të zgjidhin lëndë më shumë sesa kanë pranuar dhe si rrjedhojë në fund të vitit 2021, në raport me fundin e vitit 2020, është ngritur numri i lëndëve të pazgjidhura.



Grafikoni 2: Përqindja e lëndëve të zgjidhura dhe të pazgjidhura në DKR-të e shtatë Prokurorive Themelore gjatë vitit 2021

Gjatë vitit 2021, DKR në PTh në Prishtinë ka qenë më i ngarkuari në raport me DKR-të e PTh tjera (5,021 lëndë në punë). Konsiderueshëm ngarkesë ka edhe DKR i PTh në Mitrovicë (1,777 lëndë në punë) derisa më së paku i ngarkuar ka qenë DKR i GjTh në Gjiilan (949 lëndë në punë).¹⁶

Gjatë vitit 2021, në përgjithësi, në DKR të PTh-ve është ngritur numri i lëndëve të pazgjidhura. Kjo pasi prokurorët e këtyre departamenteve kanë zgjidhur lëndë më pak sesa që kanë pranuar. Përrjashtim në këtë rast bënë vetëm DKR i PTh në Mitrovicë dhe Gjakovë. Ngritjen më të madhe të lëndëve të pazgjidhura e ka pasur DKR i PTh në Prishtinë.

¹⁵ Raporti i Punës së Prokurorit të Shtetit për vitin 2021.

¹⁶ Po aty.

Nëse e krahasojnë numrin e lëndëve të zgjidhura në raport me numrin e prokurorëve, atëherë shohim se ka çekuilibër në mesataren e zgjidhjes së lëndëve në secilën prokurori. Me këtë rast, mesatarisht, prokurorët e DKR në PTh në Gjakovë brenda vitit kanë arritur të zgjidhin nga 211 lëndë, derisa prokurorët e DKR në PTh në Pejë kanë arritur të zgjidhin mesatarisht nga 102 lëndë. Kështu, mesatarisht, prokurorët e DKR në Gjakovë kanë zgjidhur dy herë më shumë lëndë sesa prokurorët e DKR në Pejë.

Numri i lëndëve në DKR të PTh-ve ende konsiderohet i lartë. Gjatë vitit 2021, ky numër nuk ka rënë, por është ngritur. Në anën tjetër, të dhënat flasin për një diskrepancë të konsiderueshme të mesatares së numrit të lëndëve të zgjidhura në mes të prokurorëve të DKR të një prokurorie në raport me prokurorët e DKR të një prokurorie tjetër. Kështu, prokuroritë dhe KPK duhet të analizojnë këtë gjendje në mënyrë që të ngritet efikasiteti dhe të filloj rënia graduale e numrit të lëndëve të pazgjidhura të cilat barten vit pas viti. Në këtë fazë, IKD vlerëson KPK nuk mund ta shqyrtojë mundësinë e transferimit të prokurorëve, për shkak se secili transferim në një prokurori konsiderohet se do ta dëmtonte konsiderueshëm prokurorinë tjetër. Por, KPK duhet ta inspektojë gjendjen, për të parë se përse në disa prokurori kemi numër më të madh të prokurorëve, por mungesë të paarsyeshme të efikasitetit.

Prokuroria Themelore	Lëndë të trashëguara	Lëndë të pranuar	Gjithsej në punë	Të zgjidhura	Diferenca mes lëndëve të pranuar dhe të zgjidhura	Të pazgjidhura	Mesatarja vjetore e lëndëve për prokurorë
Prishtinë	2,957	2,064	5,021	1,799	+265	3,222	128
Gjilan	324	625	949	599	+26	350	149
Prizren	863	914	1,777	829	+85	948	165
Mitrovicë	2,313	714	3,027	856	-142	2,171	153
Gjakovë	695	494	1,189	634	-140	555	211
Pejë	322	682	1,004	614	+68	390	102
Ferizaj	912	546	1,458	440	+106	1,018	110
Total	8,386	6,039	14,425	5,771	+268	8,654	140

Tabela 3: Pasqyra e lëndëve të trashëguara, pranuar, të zgjidhura dhe të pazgjidhura në shtatë Prokuroritë Themelore gjatë vitit 2021.

6. Mosvendosja në kërkesën pasurore juridike

IKD ka analizuar 108 aktgjykime të nxjerra nga gjykatat e shkallës së parë, ku ka identifikuar se në 98 raste palët e dëmtuara për realizimin e kërkesës së tyre pasurore-juridike janë udhëzuar në kontest civil. Ndërsa, në 10 vendime, IKD ka gjetur se është vendosur në mënyrë meritore edhe në raport me kërkesën pasurore juridike.

Kur nga gjykata në procedurë penale nuk merret vendim për kompensimin e palëve të dëmtuara, ato obligohen të kërkojnë të drejtën e tyre në një proces të ri gjyqësor civil. Ky rast civil tanimë konsiderohet si rast i ri dhe trajtohet sipas datës së deponimit të padisë në gjykatë, ndërkaq marrja e një epilogu mund të zgjasë me vite. Kështu, për realizimin e një të drejte, palës së dëmtuar i duhet që të presë epilogun e dy proceseve gjyqësore. Krahas dëmit që i shkaktohet palëve të dëmtuara, kjo mënyrë e veprimit ndikon edhe në ngarkesën e sistemit gjyqësor me lëndë. Në raste të caktuara, kjo mënyrë e veprimit mund të ndikojë edhe në hezitimin e palëve të dëmtuara për të kërkuar dëmshpërblimin. Për këtë arsye, në secilin rast kur është e mundur, gjyqtarët krahas çështjes penale, duhet të vendosin edhe për kërkesën pasurore juridike dhe mos të referojnë rastet në procedurë civile. Në anën tjetër, KGJK duhet ta ketë parasysh se në rastet e referuara në procedurë civile, pala e dëmtuar është duke iu nënshtruar dy procedurave gjyqësore për çështjen e njëjtë. Për këtë arsye, rastet e tilla që referohen në procedurë civile, nuk duhet të konsiderohen raste të reja, por të trajtohen sipas datës së ngritjes së aktakuzës, që konsiston me datën se kur sistemi gjyqësor ka filluar ta trajtojë rastin konkret.

Por, mos vendosjes në raport me kërkesën pasurore juridike i ka kontribuar edhe qasja e përfaqësuesve të palëve të dëmtuara. Gjatë monitorimit IKD ka gjetur se përjashtimisht rasteve kur të dëmtuar janë persona juridikë apo rasteve kur në aktakuzë është përcaktuar lartësia e dëmit, përfaqësuesit e palëve të dëmtuara nuk përcaktojnë para gjykatësve dëmin e shkaktuar nga kryesi i veprës penale e as nuk ofrojnë prova lidhur me këtë, çka e pamundëson për gjykatën përcaktimin e dëmit të shkaktuar dhe vendosjen mbi kërkesën pasurore juridike. Andaj, para së gjithash, me qëllim të mbrojtjes së interesit të palëve të dëmtuara, përfaqësuesit e tyre duhet të specifikojnë dhe argumentojnë kërkesën pasurore juridike, në mënyrë që t'ia mundësojnë dhe lehtësojnë gjykatës vendimmarrjen në raport me kërkesën pasurore juridike.

Krahas kësaj, në Prokurorinë e Shtetit thonë se në këtë pjesë, rolin e vet duhet ta luajë edhe policia dhe prokuroria. “[E]dhe policia e prokuroria mund të bëjnë shumë në këtë drejtim, dhe edhe për këtë aspekt kemi tërhequr vëmendjen në raportet tona. Nëse hetimet bëhen në mënyrë gjithëpërfshirëse, qysh në fazën e hetimeve, dëmi duhet precizuar, kurdo që kjo është e mundur. Një gjë e tillë do e mundësojë që një proces gjyqësor të jetë i plotë, dhe shqyrtimi është i plotë, vetëm kur adresohet edhe dëmi/dobia pasurore” ka deklaruar Prokurori Shqipdon Fazliu.

Në anën tjetër, neni 56 i Kodit Penal në fuqi ka paraparë që dënimi me kusht mund të përfshijë edhe urdhrin për të përmbushur një apo më shumë nga detyrime, ndër to edhe kompensimin ose dëmshpërblimin e viktimës së veprës penale apo kthimin e dobisë pasurore të fituar me kryerjen e veprës penale. Në aktgjykimet e analizuara nga IKD, ku dënimi i shqiptuar ka qenë me kusht, nuk është gjetur se janë shqiptuar këta urdhra. Kështu, edhe në këtë pikë, gjykatës i mungon një qasje proaktive në drejtim të mbrojtjes së të drejtave të palës së dëmtuar.

7. Mosaplikimi i dënimeve plotësuese

Gjatë analizimit të aktgjykimeve, IKD ka hasur në raste të shumta, kur ka qenë i mundur aplikimi i dënimeve plotësuese,¹⁷ por se i njëjti nuk është shqiptuar nga ana e gjykatës. Në mbi 30 aktgjykime vërehet mungesa e dënimit plotësues të ndalimit të ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik, kur të pandehurit akuzoheshin se kanë kryer veprën penale në cilësi të personit zyrtar. Ndërkaq, janë identifikuar mbi 10 raste ku të dënuarit kanë qenë shtetas të huaj dhe ndaj të njëjtëve nuk është shqiptuar dënimi plotësues i dëbimit të të huajit nga territori i Republikës së Kosovës. Në këto raste, në parim, aktgjykimet nuk përmbajnë arsyetim se pse këto dënime plotësuese nuk janë shqiptuar.

Pamundësia e arritjes së qëllimit të dënimit dhe individualizimit të tij vetëm me anë të shqiptimit të dënimeve kryesore apo atyre alternative, është një ndër arsyet se pse ligji ka mundësua që krahas dënimit kryesor/alternativ, të pandehurit t'i shqiptohen edhe dënimet plotësuese. P.sh. nëse një i dënuar për kryerje të veprës penale në cilësi të personit zyrtar dënohet me një dënim alternativ, sikurse dënimi me kusht, por ende vazhdon ushtrimin e funksionit të tij, në parim, është vështirë të konsiderohet se ai dënim është adekuat për arritjen e qëllimit të dënimit. Kështu, në mënyrë që varësisht specifikave të rastit dënimi të ketë mundësi më të mëdha në arritjen e qëllimit të tij, gjykatat duhet të aplikojnë edhe dënimet plotësuese.

8. Konfiskimi i zgjeruar

IKD në raportet e saj mbi krimet e rënda vazhdimisht ka identifikuar neglizhencë të sistemit prokurorial për luftimin e kriminalitetit përmes konfiskimit të pasurisë.¹⁸ Në kuadër të kornizës ligjore që rregullon fushën e konfiskimit të pasurisë është Ligji NR. 06/L-087 për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë (LKZKP).

LKZKP, për një sërë veprash penale, mundëson aplikimin e konfiskimit civil në rastet kur i pandehuri shpallet fajtor.¹⁹ Gjatë vitit 2021, në asnjë rast nuk është aplikuar ky ligj nga Prokurorët e Shtetit. Raportet e Koordinatorit Kombëtar për Luftimin e Krimit Ekonomik nuk japin mjaftueshëm arsye se pse nuk zbatohet ky ligj, por vetëm e konsiderojnë si të metë mos aplikimin e tij²⁰, derisa raportet paraprake theksonin nevojën e veprimit të mekanizmave të llogaridhënies në këtë fushë²¹.

¹⁷ Neni 59, Kodi Penal nr. 06/L-074. i Republikës së Kosovës.

¹⁸ Gashi, L. Kadriu, M. “Shënjestrimet e dështuara”, IKD, (mars 2020) Fq. 29, në <https://kli-ks.org/shenjestrimet-e-deshtuara/>; Gashi, L. Kadriu, M. “Dështimet në rastet e shënjestruara”, IKD, (qershor 2019), Fq.6, në <https://kli-ks.org/deshitimet-ne-rastet-e-shenjestruara/>; Shala, G. Thaqi, M. “Ndjekja dhe gjykimi i korrupsionit në prokurimin publik”, IKD, (dhjetor 2021), Fq. 15, në: <https://kli-ks.org/ndjekja-dhe-gjykimi-i-korrupsionit-ne-prokurimin-publik/> (Qasur së fundi 17 qershor 2022).

¹⁹ Neni 2, Ligj nr.06/L-087 për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë.

²⁰ Raporti tremujor janar-mars 2021 për aktivitetet dhe rekomandimet e koordinatorit kombëtar për luftimin e krimit ekonomik, në: <https://prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/Raporti%20i%20Koordinatorit%20komb%C3%ABtar%20p%C3%ABr%20luft>

Fakti se për aplikimin e këtij ligji, në raste të caktuara, kërkohet vetëm shpallja fajtor e të pandehurit dhe përsëri ky ligj nuk zbatohet, flet për një neglizhencë të paarsyeshme të Prokurorit të Shtetit për luftimin e kriminalitetit përmes konfiskimit të përcaktuar në LKZKP.

[imin%20e%20krimit%20ekonomik%2C%20janar%20-%20mars%202021.pdf](https://prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/Raporti%20i%20Koordinatorit%20komb%C3%ABtar%20p%C3%ABr%20luftimin%20e%20krimit%20ekonomik%2C%20janar%20-%20mars%202021.pdf) ; Raporti tremujor prill – qershor 2021 për aktivitetet dhe rekomandimet e koordinatorit kombëtar për luftimin e krimit ekonomik, në:

<https://prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/Raporti%20i%20Koordinatorit%20komb%C3%ABtar%20p%C3%ABr%20luftimin%20e%20krimit%20ekonomik%2C%20prill%20-%20qershor%20%202021.pdf>; Raporti tremujor tetor-dhjetor 2021 për aktivitetet dhe rekomandimet e koordinatorit kombëtar për luftimin e krimit ekonomik, në :

<https://prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/Raporti%20i%20Koordinatorit%20komb%C3%ABtar%20p%C3%ABr%20luftimin%20e%20krimit%20ekonomik%2C%20prill%20-%20qershor%20%202021.pdf> (Qasur së fundi 17 qershor 2022).

²¹ Raporti tremujor tetor-dhjetor 2020 për aktivitetet dhe rekomandimet e koordinatorit kombëtar për luftimin e krimit ekonomik, f.8. në <https://prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/Dokumente%20Publikime/KPK/Raporte/Raporti%20vjetor%202020%20i%20Koordinatorit%20Kombëtar%20për%20luftimin%20e%20krimit%20ekonomik.pdf> (Qasur së fundi 17 qershor 2022).